

- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për oferte;
- Formulari i njoftimit të fituesit;
- Formulari i publikimit të njoftimit të fituesit;
- Procesverbali/et i/e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

11. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës në kopje fizike, me poste ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e konkurimit .

BASHKIA TROPOJË

NJOFTIM FITUESI PËR DHËNIEN ME QIRA

Autoriteti i dhënies me qera : Bashkia Tropojë njofton se në konkurimin publik të zhvilluar me datën 24.04.2023, ora 10.00 , publikimi i të cilit është bërë me datë 03.04.2023 në buletin e njoftimeve publike nr.30 me objekt : dhënie me qera:

Fillimi i procedurave, për dhënien me qira me anë të konkurimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor publik, e njohur si “Kasaj” e fshatit Tropojë me sipërfaqe 13 ha me afat përdorimi (qeraje) 10 vjet. Çmimi dysheme për fillimin e konkurimit është 13000 leke në vit, sipas përcaktimit të VKM-se nr 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e cmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për vëprimtari ekonomike, si dhe prodhime drusore dhe jodrusore pyjore”, si dhe vendimit të Këshillit Bashkiak Tropojë Nr.103 Prot datë 03.12.2021 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore 2022.

Njoftojme se, kanë qene pjesemarrres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1.Subjekti Sokol Dermishaj numri i NIPT-it M29625601M

Oferta e paraqitur për dhënien me qira të ekonomisë Pyjore “Lugina e Tropojës”, pjese nga ngastra nr.113a dhe 117a te sipërfaqes prej 13 ha “ Për veprimtari Agropylltari ” me afat përdorimi (qiraje), 10(dhjetë) vite, është 130000 (njëqindetridhjetemijë) lekë në vit pa TVSH.

- S’ka të skualifikuar .

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë:

1. Subjekti Sokol Dermishaj

- Adresa: Bashkia Tropojë, Tropojë, Rruga Ram Sadria, fshati Tropojë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 130 000 (njëqindetridhjetemijë) lekë në vit është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Tropojë, me adresë Sheshi Azem Hajdari , Bajram Curri kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç

parashikohet në dokumentat e konkurimit publik, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike nr.9643 date 20.11.2006

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 24.04.2023

Ankesa: S'ka

--